



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM
Nr. 38 datë 26.10.2023**

**“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË
QIRASË DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË PËR
VITIN 2023”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 26.10.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, nenit 24, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; të nenit 38 të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, pika 4/a e VKM-së nr. 362, datë 29.05.2019 “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare mujore në treg të lirë sipas strukturave të apartamenteve në zonat urbane dhe ato rurale në territorin e Bashkisë Shkodër, që do të zbatohen për vitin 2024, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi mesatar në zonat urbane (lekë pa tvsh)	Çmimi mesatar në zonat rurale (lekë pa tvsh)
1	Banesa me qira (Apartament tip garsonierë)	muaj	1	16,000	12,500
2	Banesa me qira (Apartament 1 + 1)	muaj	1	22,700	17,500

3	Banesa me qira (Apartament 2 + 1)	muaj	1	31,500	21,000
4	Banesa me qira (Apartament 3 + 1)	muaj	1	38,500	25,000

2. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barasvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura në këtë projekt-vendim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR

Oltion LULI



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miratuar me 41 vota

Vota Pro 41

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 30.10.2023